



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____.____.2020

Lënda: Kthim përgjigje

Në vijim të kërkesës Tuaj, drejtuar Bashkisë Shkodër me anë të postës elektronike datë 14.10.2020, Ju informojmë se projektet e financuara në kuadër të programeve të Bashkimi Evropian janë si më poshtë:

Programi	Titulli i aplikimit	Objekti	Kohëzgjatja	Vlera
Horizon 2020	PARK4SUMP “Veprimet tregojnë se si Park4SUMP do të realizojë transportin e qendrueshëm në zonat urbane duke integruar strategjikisht zgjidhjet e reja të menaxhimit të parkimit në politikat e SUMP”	Projekti ka për qëllim përmirësimin e lëvizshmërisë urbane nëpërmjet menaxhimit të hapësirave të parkimit dhe integrimin e saj në planet e levizshmërisë urbane. Nëpërmjet këtij projekti do të merren shembujt dhe ekspertiza më të mirë në Evropë për menaxhimin e parkimit. PARK4SUMP do të optimizojë përdorimin e infrastrukturës ekzistuese duke ndikuar ndjeshëm në shmangien e trafikut, uljen e kostos dhe rritjen	36 muaj	29,422.50 Euro

		e të ardhurave. Për më tepër, do të inkurajohet ecja, çiklizmi dhe transporti publik.		
Programi EuropeAid	DEAR – “Modelimi i qyteteve të drejta: Integrimi i Agjendës 2030 brenda politikave lokale, në kohën e flukseve të mëdha të migrimit dhe refugjatëve. Një projekt advokimi udhëhequr dhe zbatuar nga autoritetet lokale”, CSO-LA/2017/388-138.	Qëllimi i përgjithshëm i projektit është të kontribuojë në promovimin e të kuptuarit kritik të roleve dhe përgjegjësive të autoriteteve lokale dhe të qytetarëve në arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) të Agjendës 2030, si dhe rëndësinë e lokalizimit të Agjendës 2030 nga bashkitë dhe autoritetet vendore në hartimin e politikave lokale	36 muaj	63.344 Euro

Metodologjia e punës e ndjekur nga Bashkia Shkodër për aplikimin dhe zbatimin e projekteve të financuara nga programe të Bashkimit Evropian dhe jo vetëm, është e tillë që në varësi të fushave dhe natyrës së projekteve, aplikimi dhe me pas zbatimi i tyre bëhet nga drejtoritë respektive. Kështu projekti DEAR është pjesë e programit buxhetor P10430 Kujdesi social për familjet dhe fëmijët, fisha P10430.O2.A5 ndërsa projekti PARK4SUMP është pjesë e programit buxhetor P04520: Transporti rrugor, fisha P04520.O4.A3. Në lidhje me pikën 2, 3 dhe 5 të kërkesës tuaj, ju informojmë se Bashkia Shkodër nuk është para një rasti të tillë, natyra e projekteve nuk ka të bëjë me procedura tenderimi për shpallje të kompanive fituese.

Sjellim në vëmendje që të dy këto projekte janë duke u zbatuar dhe për rrjedhojë nuk ka përfunduar procesi i auditimit. Ndodhur në këto kushte dhe në respektim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2019 “Për të drejtën e informimit” pika 7, pika 17, kopjet e këtyre projekteve nuk mund të vihet në dispozicion.

Për më shumë informacion ju lutem adresohuni autoritetit kontraktor, menaxhues të programeve të përmendura mësipër.

Në lidhje me piken 4 të kërkesës tuaj, ju informojmë se është duke u zbatuar projekti i "Bregut Perëndimor të Liqenit të Shkodrës", në kuadër të programit për "Turizmin e Integruar në 4 Bashkitë e përcaktuara në Shqipëri" financuar nga BERZH, BE dhe Qeveria Shqiptare. Vlera totale e projektit është 20.7 milion Euro. Deri tani është implementuar vetëm komponenti "Rindërtimi i qendrës Shiroka", me një vlerë prej 2.5 milion Euro.

I gjithë procesi është menaxhuar nga autoriteti i Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

Të gjitha të dhënat e listuara më sipër janë të aksesueshme në faqen zyrtare të Bashkisë Shkodër:
www.bashkiashkoder.gov.al

Me respekt,